

### Përmbledhje

Ekonomia e eurozonës, sipas të dhënave preliminare të Eurostatit, është karakterizuar me një rritje të ngadalësuar të aktivitetit ekonomik në gjysmën e parë të vitit 2019 (rreth 1.2 përqind), gjë që është përkthyer edhe në dinamikat e dobësuar të shkallës së inflacionit (1.4 përqind). Ngjashëm me eurozonën, edhe aktiviteti ekonomik në vendet e Ballkanit Perëndimor është karakterizuar me rritje të ngadalësuar (3.2 përqind në gjysmën e parë të vitit 2019).

Ndryshe, sipas të dhënave preliminare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), në TM1 2019 BPV-ja reale qëndroi në 4.1 përqind, rritje kjo e mbështetur kryesisht nga rritja e konsumit dhe investimeve përderisa eksportet neto ndikuan negativisht. Meqenëse të dhënat zyrtare për TM2 2019 nuk janë publikuar ende, mbështetur në tregues tjerë me frekuencë më të lartë publikimi, rritja ekonomike gjatë këtij tremujori vlerësohet të ketë qenë më e lartë. Vlerësimet për një rritje më të lartë mbështeten në zhvillimet pozitive në sektorin e jashtëm (rritjes së përshpejtuar të eksportit të mallrave dhe shërbimeve, IHD-ve, remitencave, kompensimit të punëtorëve) si dhe rritjes së konsumit publik.

Niveli i çmimeve të konsumit deri në qershor 2019 është rritur për 3.1 përqind, kryesisht si rezultat i rritjes së çmimeve të ushqimit. Inflacioni bazë (që përjashton ushqimin, energjinë, pijet alkoolike dhe duhanin), shënoi rritje prej vetëm 0.4 përqind apo 2.7 pikë përqindje më ulët krahasuar me inflacionin e përgjithshëm.

Sektori fiskal deri në qershor 2019 u karakterizua me rritje të të hyrave prej 7.7 përqind dhe ngadalësim të rritjes së shpenzimeve buxhetore prej 2.9 përqind. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi suficit primar buxhetor prej 0.3 milionë euro (37.1 milionë euro deficit në periudhën e njëjtë të vitit 2018). Borxhi publik në TM2 2019 ka arritur në 1.13 miliardë euro, që është për 9.3 përqind më i lartë krahasuar me TM2 2018. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 16.5 përqind nga 16.3 përqind sa ishte në TM2 2018.

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2019, sektorët përbërës të sistemit financiar u zgjeruan për 153.3 milionë euro, kryesisht si rezultat i rritjes së aktivitetit të sektorit bankar dhe sektorit pensional. Edhe sektori mikrofinanciar dhe i sigurimeve u karakterizuan me rritje të aktivitetit, megjithëse ky i fundit është përballur me rezultate negative financiare.

Deri në qershor 2019, sektori i jashtëm është karakterizuar me zvogëlim të deficitit të llogarisë rrjedhëse për 10.0 përqind. Zvogëlimi i deficitit të llogarisë rrjedhëse i atribuohet rritjes së bilanceve pozitive të shërbimeve, të ardhurave parësore dhe të ardhurave dytësore ndërsa deficitit i mallrave shënoj rritje. Në kuadër të bilancit të pagesave, remitencat dhe Investimet e Huaja Direkte (IHD) shënuan rritje vjetore prej 5.5 përqind përkatësisht 53.2 përqind.

## PËRMBAJTJA

<b>Përmbledhje</b> -----	<b>i</b>
<b>Eurozona dhe Ballkani Perëndimor</b> -----	<b>4</b>
<b>Ekonomia e Kosovës</b> -----	<b>6</b>
<b>Sektori Real</b> -----	<b>6</b>
<b>Çmimet</b> -----	<b>6</b>
<b>Sektori Fiskal</b> -----	<b>7</b>
<b>Sektori Financiar</b> -----	<b>8</b>
<b>Sektori i Jashtëm</b> -----	<b>9</b>

## FIGURAT DHE TABELAT


Figura 1. Zhvillimet makroekonomike në Eurozonë-----	04
Figura 2. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë-----	06
Figura 3. Inflacioni I përgjithshëm dhe inflacioni bazë-----	07
Figura 4. Deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe komponentët e saj-----	09
Figura 5. Eksporti dhe importi i mallrave-----	10
Figura 6. Struktura e eksporteve sipas kategorive-----	10
Figura 7. Struktura e importeve sipas kategorive-----	10
Figura 8. Remitencat-----	11
Figura 9. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponentëve-----	11
Tabela 1. Norma e rritjes së BPV-së reale-----	05
Tabela 2. Shkalla vjetore e inflacionit-----	05
Tabela 3. Kontributi i kategorive specifike në gjithsej inflacionin-----	07
Tabela 4. Treguesit e zgjedhur makroekonomik-----	13

## **SHKURTESAT:**

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
EJL	Evropa Juglindore
EUR	Valuta Euro
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IÇI	Indeksi i Çmimit të Importit
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IHD	Investimet e Huaja Direkte
MF	Ministria e Financave e Republikës së Kosovës
NRER	Norma Reale Efektive e Këmbimit
WEO	World Economic Outlook

## Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Sipas të dhënave preliminare të Agjencisë Statistikore të Bashkimit Evropian (Eurostat), ekonomia e eurozonës shënoi rritje vjetore prej 1.2 përqind në gjysmën e parë të vitit 2019, që është një normë e ngadalësuar e rritjes kundrejt rritjes prej 2.3 përqind në gjysmën e parë të vitit 2018 (figura 1).



Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik pasqyron kryesisht dobësitë në tregtinë globale dhe pasiguritë lidhur me kërcënimet për rritje të proteksionizmit, mundësitë për një Brexit pa marrëveshje, zvogëlimi i prodhimit të makinave, etj.. Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik e veçanërisht në sektorët e ekspozuar ndaj tregtisë globale, ka ndikuar besueshmërinë e bizneseve duke rezultuar kështu në pritje jo aq optimiste edhe për periudhat në vazhdim. Projektionet e Bankës Qendrore Evropiane (BQE) sugjerojnë për një rritje të

ngadalësuar ekonomike në tre vitet e ardhshme (1.2 përqind në 2019, 1.4 përqind në 2021).

Në linjë me ngadalësimin e aktivitetit ekonomik, edhe shkalla e inflacionit ishte më e ulët krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018. Mesatarja e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit në eurozonë gjatë gjysmës së parë të vitit 2019 ishte 1.4 përqind (1.5 përqind në gjysmën e parë të vitit 2018) (figura 1). Si rezultat i nivelit të ulët të inflacionit, në korrik 2019, Këshilli Mbikëqyrës i BQE-së vendosi t'i mbajë të pandryshuara normën e interesit të operacioneve kryesore të refinancimit (0.0 përqind), normën e interesit mbi lehtësirat kreditore (0.25 përqind) dhe depozitare (-0.40 përqind). Gjithashtu, Këshilli Mbikëqyrës ka paralajmëruar se synon të vazhdojë riinvestimin e plotë të pagesave të principalit nga asetet që maturojnë (që janë blerë në kuadër të programit), për një periudhë të zgjatur kohe, për aq sa do të vlerësohet si e nevojshme për të siguruar kushte të favorshme të likuiditetit në treg.

Aktiviteti kreditues dhe depozitues në eurozonë ka vazhduar të rritet, rritje që është evidentuar si tek ndërmarrjet ashtu edhe tek ekonomitë familjare. Kreditë ndaj ndërmarrjeve shënuan rritje prej 3.3 përqind ndërsa kreditë ndaj ekonomive familjare shënuan rritje prej 3.2 përqind. Në anën tjetër, depozitat në sistemin bankar janë rritur akoma më shumë dhe kanë shënuar normën e rritjes prej 5.2 përqind.

Edhe në vendet e Ballkanit Perëndimor, aktiviteti ekonomik në TM1 2019<sup>1</sup> ka shënuar rritje vjetore të

<sup>1</sup> Të dhënat për TM2 2019 nuk janë publikuar ende, ndërsa për Bosnje e Hercegovinën nuk janë publikuar që nga TM2 2018.

ngadalësuar prej mesatarisht 3.2 përqind (3.6 përqind në TM1 2018). Kosova dhe Maqedonia e Veriut shënuan rritje më të lartë, ndërsa Mali i Zi, Serbia dhe Shqipëria shënuan rritje të ngadalësuar (tabela 1).

**Tabela 1. Norma e rritjes së BPV-së reale**

Përshkrimi	2018 TM1	2018 TM2	2018 TM3	2018 TM4	2019 TM1
Kosova	3.5	4.7	3.4	3.8	4.1
Mali i Zi	4.5	4.9	5.0	4.8	3.0
Maqedonia e Veriut	0.9	3.0	3.0	3.7	4.1
Serbia	4.8	4.9	4.1	3.4	2.7
Shqipëria	4.3	4.3	4.7	3.3	2.2

Burimi: Zyrat kombëtare statistikore të vendeve përkatëse

Në gjysmën e parë të vitit 2019, norma mesatare e inflacionit në vendet e Ballkanit Perëndimor ishte pothuajse e pandryshuar prej 1.8 përqind. Normat më të larta të inflacionit ishin evidente kryesisht në Kosovë dhe Serbi, ndërsa në Mal të Zi, Shqipëri dhe Maqedoni të Veriut normat e inflacionit ishin më të ulëta (tabela 2).

**Tabela 2. Shkalla vjetore e inflacionit**

Përshkrimi	2018 TM1	2018 TM2	2018 TM3	2018 TM4	2019 TM1	2019 TM2
Kosova	0.0	0.7	1.4	2.2	3.2	3.3
Mali i Zi	3.7	3.7	2.4	1.7	0.4	0.5
Maqedonia e Veriut	0.8	1.6	1.5	1.2	1.2	1.2
Serbia	1.6	1.8	2.4	2.0	2.4	2.3
Shqipëria	1.6	1.9	2.1	1.5	1.9	1.5

Burimi: Zyrat kombëtare statistikore të vendeve përkatëse

Sa i përket zhvillimeve në sektorin bankar, rritja e kredive dhe depozitave ishte e konsiderueshme dhe me diferenca të theksuara ndërmjet vendeve. Në TM2 2019, norma mesatare e rritjes së kredive ishte 5.9 përqind (6.3 përqind në TM2 2018). Vendet të cilat shënuan rritje më të lartë kreditimit ishin Kosova dhe Maqedonia e Veriut (10.5 përqind përkatësisht 7.5 përqind) ndërsa vendet tjera shënuan rritje më të ulët. Depozitat shënuan normë edhe më të lartë të rritjes krahasuar me kreditë. Në TM2 2019, norma mesatare e rritjes së depozitave ishte 6.4 përqind në nivel të rajonit. Tek depozitat, norma më e lartë e rritjes është

shënuar në Serbi me 11.2 përqind, pasuar nga Kosova me 11.0 përqind, Maqedonia e Veriut me 9.0 përqind, Bosnja e Hercegovina me 7.5 përqind, etj.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2019, euro është vlerësuar ndaj lirës turke për 25.6 përqind ndërsa është zhvlerësuar ndaj valutave tjera kryesore por edhe ndaj valutave të vendeve të rajonit. Ndaj dollarit amerikan është zhvlerësuar për 6.7 përqind, ndaj lekut shqiptar 4.7 përqind, ndaj frankës zvicerane për 3.4 përqind dhe dinarit serb për 0.2 përqind.


## Ekonomia e Kosovës

### Sektori Real

Sipas të dhënave tremujore të ASK-së, aktiviteti ekonomik ka shënuar rritje të përsheptuar në TM1 2019 prej 4.1 përqind. Kontributin më të madh në rritjen e BPV-së e kishin tregtia që shënoi rritje për 4.0 përqind, furnizimi me energji elektrike, gaz, ujë (6.4 përqind rritje) dhe aktivitetet financiare dhe të sigurimit (6.4 përqindje rritje).

Sipas qasjes së shpenzimeve, konsumi shënoi kontributin kryesor në rritjen ekonomike me 5.2 pikë përqindje, ndërsa investimet shënuan rritje të ngadalësuar dhe kontribuuan me 2.0 pikë përqindje. Në anën tjetër, eksportet neto ndikuan negativisht në rritjen e BPV-së me 3.1 pikë përqindje (figura 2).

Figura 2. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë



Burimi: ASK (2019) dhe llogaritjet e BQK -së

Në kuadër të konsumit, konsumi privat ka kontribuar me 4.6 pikë përqindje (1.3 pikë përqindje në TM1 2018). Ky kontribut pozitiv mbështetet nga zhvillimet pozitive që janë regjistruar në burimet kryesore të financimit të konsumit privat. Remitencat dhe kompensimi i punëtorëve shënuan rritje vjetore prej 8.5 përkatësisht 13.1 përqind. Tregues tjetër i rritjes së

konsumit privat në TM1 2019 është edhe rritja prej 8.9 përqind të importit të mallrave të konsumit. Përveç rritjes së konsumit privat, edhe shpenzimet rrjedhëse të qeverisë shënuan rritje prej 6.0 përqind në TM1 2019.


Rritja e ngadalësuar e investimeve i atribuohet kryesisht rënies së investimeve kapitale të qeverisë prej 46.2 përqind në TM1 2019, por edhe rënies së kredive investuese prej 6.4 përqind. Në anën tjetër, IHD-të u dyfishuan gjatë këtij tremujori, ndërkohë që edhe importi i mallrave kapitale shënoi rritje prej 14.8 përqind.

Meqenëse të dhënat zyrtare nga ASK-ja për BPV-në e TM2 2019 nuk janë publikuar ende, mbështetur në tregues tjerë me frekuencë më të lartë publikimi, BQK vlerëson se rritja ekonomike tremujore dhe vjetore gjatë këtij tremujori pritet të jetë më e lartë, gjë që është në linjë me parashikimin e BQK-së për vitin 2019 i cili sugjeron rritje vjetore prej 4.2 përqind. Pritjet e BQK-së për rritje më të lartë kryesisht mbështeten në zhvillimet pozitive në sektorin e jashtëm (rritjes së përsheptuar të eksportit të mallrave dhe shërbimeve, IHD-ve, remitencave, kompensimit të punëtorëve) si dhe rritjes së konsumit publik. Në anë tjetër, deri në muajin qershor 2019 investimet publike kanë shënuar rënie ndërsa kreditë e reja mbetën në nivel pothuajse të ngjashëm me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

### Çmimet

Indeksi i çmimeve të konsumit u rrit ndjeshëm që nga tremujori i fundit i vitit 2018 dhe është duke vazhduar këtë trend të rritjes edhe në vitin 2019 (figura 3).

Figura 3. Inflacioni i përgjithshëm dhe inflacioni bazë, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2019)

Deri në qershor 2019 norma mesatare e rritjes së çmimeve të konsumit ishte 3.1 përqind (0.3 përqind në periudhën e njëjtë të vitit 2018). Kjo rritje e çmimeve ishte më e theksuar tek çmimet e ushqimit dhe pijeve joalkoolike, të cilat kontribuuan me 2.6 pikë përqindje në inflacionin e përgjithshëm, pasuar nga çmimet transportit me 0.3 pikë përqindje si dhe çmimet e pijeve alkoolike dhe duhanit me 0.2 pikë përqindje (tabela 3).

Tabela 3. Kontributi i kategorive specifike në gjithsej inflacionin

Përshkrimi	Peshat 2019	Norma e inflacionit	Kontributi
<b>GJITHSEJ</b>	<b>100.0%</b>	<b>3.1</b>	<b>3.22</b>
Ushqimi dhe pijet joalkoolike	40.0%	6.3	2.59
Pijet alkoolike dhe duhani	5.6%	3.0	0.18
Veshmbathja	3.9%	0.4	0.01
Energjia	7.7%	0.3	0.01
Orenditë	7.9%	0.7	0.05
Shëndetësia	2.5%	0.3	0.00
Transporti	15.4%	1.6	0.31
Komunikimi	3.7%	-0.2	-0.01
Rekreacioni	4.4%	0.2	0.00
Arsimi	1.0%	-1.0	-0.01
Hoteleria	3.1%	1.8	0.06
Mallrat dhe shërbimet tjera	4.9%	1.3	0.06

Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së

Siç shihet në tabelë, shporta e konsumatorit kosovarë karakterizohet me pjesëmarrje shumë të lartë të

produkteve me lëvizje sezonale të çmimeve (ushqim, energji, pije alkoolike dhe duhan) dhe përjashtimi i këtyre komponentëve bënë që inflacioni bazë të jetë më stabil (figura 3). Deri në qershor 2019, inflacioni bazë rezultoi të jetë 0.4 përqind, apo 2.7 pikë përqindje më i ulët se sa inflacioni i përgjithshëm.

Për shkak të varësisë së lartë të ekonomisë së Kosovës nga importi, dinamikat e shportës së konsumatorit kosovarë përcaktohen kryesisht nga lëvizja e çmimeve të importit, të cilat deri në qershor 2019 shënuan rritje mesatare prej 3.7 përqind që është nivel paksa më i lartë se sa indeksi i çmimeve të konsumit. Përveç çmimeve të importit me rritje prej 1.5 përqind janë karakterizuar edhe çmimet e prodhimit por që kjo normë e rritjes ishte dukshëm më e ulët krahasuar me çmimet e importit.

### Sektori Fiskal

Të hyrat buxhetore<sup>2</sup> deri në qershor 2019 arritën vlerën neto prej 853.5 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 7.7 përqind, ndërsa shpenzimet buxhetore<sup>3</sup> arritën vlerën prej 853.2 milionë euro që paraqet një rritje vjetore prej 2.9 përqind. Si rezultat i rritjes më të lartë të të hyrave buxhetore krahasuar me shpenzimet, buxheti i Kosovës regjistroi suficit primar buxhetor prej 0.3 milionë euro (37.1 milionë euro deficit në periudhën e njëjtë të vitit 2018).

Rritja e përshpejtuar e të hyrave buxhetore u diktua kryesisht nga ecuria e zërave të lidhur me importin e mallrave. Të hyrat tatimore indirekte përbëjnë rreth 73.7 përqind të gjithsej të hyrave buxhetore dhe janë

<sup>2</sup> Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk përfshihen të hyrat nga huamarrjet, të hyrat nga privatizimi, pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe pranimet nga depozitat në mirëbesim.

<sup>3</sup> Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk përfshihen pagesat e borxhit, pagesat për anëtarësim në IFN dhe kthimet nga fondet e depozitave.



kryesisht të hyra tatimore që mblidhen në kufi. Këto të hyra arritën vlerën prej 628.9 milionë euro apo 4.7 përqind më shumë krahasuar me periudhën e njëjtët të vitit 2018. Të hyrave tatimore direkte arritën vlerën prej 146.8 milionë euro apo 9.7 përqind rritje. Të hyrat jo-tatimore shënuan rritje prej 13.0 përqind dhe arritën vlerën prej 98.4 milionë euro.

Rritja më e ngadalësuar e shpenzimeve buxhetore erdhi si pasojë e vonësive në aprovimin e Buxhetit për vitin 2019 nga ana e Kuvendit të Kosovës. Kategoria kryesore që kontribuoi në rritjen e ngadalësuar të shpenzimeve buxhetore ishte ajo e shpenzimeve kapitale të cilat ishin për 23.1 përqind më të ulëta krahasuar me periudhën e njëjtët të vitit 2018. Kategoritë tjera të shpenzimeve buxhetore shënuan rritje. Shpenzimet qeveritare për paga shënuan rritje prej 3.8 përqind dhe arritën vlerën prej 304.9 milionë euro. Shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime (përfshihen edhe shpenzimet komunale) shënuan rritje për 9.1 përqind dhe arritën vlerën prej 113.9 milionë euro. Subvencionet dhe transferet shënuan rritje për 18.0 përqind dhe arritën vlerën prej 299.2 milionë euro.

Borxhi publik në TM2 2019 ka arritur në 1.13 miliardë euro që është për 9.3 përqind më i lartë krahasuar me TM2 2018. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 16.5 përqind nga 16.3 përqind sa ishte në TM2 2018. Përkundër rritjes, ky nivel i borxhit është ende larg pragut prej 40 përqind të paraparë me ligj dhe po ashtu e mbanë Kosovën në pozitën e vendit me shkallën më të ulët të borxhit publik krahasuar me vendet e rajonit.

### **Sektori Financiar**<sup>4</sup>

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2019, sistemi financiar u karakterizua me rritje të aseteve të përgjithshme për 153.3 milionë euro, mbështetur kryesisht në rritjen e aseteve nga sektori bankar dhe sektori pensional.

Kreditimi, si kontribuuesi kryesor në rritjen e aseteve, vazhdoi trendin pozitiv të rritjes, edhe pse rritja në këtë tremujor ishte më e ulët se rritja e shënuar në tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Me rritje të kreditimit u karakterizuan të dy kategoritë, ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare.

Aktiviteti kreditues i sektorit kryesisht u mbështet nga rritja e shënuar në burimet e brendshme, ku kategori dominuese janë depozitat. Rritja e normave të interesit, veçanërisht normat e interesit në kreditë për ekonomitë familjare, vlerësohet të ketë qenë faktor i rëndësishëm në rritjen e depozitave. Për dallim nga tremujorët e kaluar ku dominonin depozitat e transferueshme, këtë tremujor depozitat e afatizuara dominuan strukturën e gjithsej depozitave të sektorit.

Dinamikat në afarizmin e sektorit ndikuan që performanca financiare e sektorit bankar gjatë këtij tremujori të jetë pozitive, edhe pse me një rritje margjinale krahas periudhës së njëjtë të vitit të kaluar. Vlera e profitit të realizuar gjatë TM2 2019 rezultoi të jetë për 0.4 milionë euro më e lartë krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak, duke arritur në 21.2 milionë euro. Profiti më i lartë i realizuar vetëm gjatë tremujorit të dytë të vitit 2019 krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak i'u atribuua

<sup>4</sup> Për më shumë informata rreth zhvillimeve në sektorin financiar referojuni publikimit: Vlerësimi Tremujor i Sistemit Financiarë (TM2 2019) i publikuar në faqen e internetit të BQK-së.



kryesisht rritjes më të lartë të të hyrave nga interesi në kredi.

Cilësia e portofolit kreditor të sektorit bankar u përmirësua tutje, duke regjistruar nivelin më të ulët të kredive jo-performuese që nga gjysma e dytë e vitit 2010 prej 2.5 përqind, me një mbulueshmëri të kënaqshme të kredive jo-performuese me provizione prej 161.2 përqind. Për më tepër, Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit prej 16.8 përqind dhe niveli i likuiditetit, shprehur përmes raportit të aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra prej 35.1 përqind sugjerojnë që sektori bankar është i qëndrueshëm ndaj rreziqeve potenciale që mund të shfaqen.


Sektori pensional vazhdon të zgjerohet duke u bazuar në kthimin pozitiv nga investimet si dhe kontributet e arkëtuara gjatë kësaj periudhe. Në të njëjtën periudhë, sektori i sigurimeve shënoi rritje të aktivitetit. Megjithatë, përkundër rritjes së primeve të shkruara, sektori i sigurimeve u karakterizua me rezultate negative financiare si pasojë e rritjes së shpenzimeve operative dhe kompenzimeve për dëmet e paguara. Sektori mikrofinanciar, përkundër rritjes, ka treguar shenja të ngadalësimit të aktivitetit në periudhën raportuese. Në TM2 2019, ky sektor u karakterizua me ngadalësim të rritjes së aktivitetit kreditues, ulje të profitit të realizuar, dhe rritje të kredive me probleme.

Në TM2 2019, Qeveria e Kosovës emetoi borxh në vlerë prej 110 milionë euro, në një ambient ku ofertat prej institucionet financiare tejkaluan shumën e kërkuar nga Ministria e Financave.

## Sektori i Jashtëm

Deri në qershor 2019, deficitin e llogarisë rrjedhëse ka arritur në 382.2 milionë euro që është për 10.0 përqind më i ulët krahasuar me periudhën e njëjtët të vitit 2018. Zvogëlimi i deficitit të llogarisë rrjedhëse i atribuohet rritjes së bilanceve pozitive të shërbimeve, të ardhurave parësore dhe të ardhurave dytësore ndërsa deficitin e mallrave ka shënuar rritje (figura 4).

Figura 4. Deficitin e llogarisë rrjedhëse dhe komponentët e saj, në milionë euro



Burimi: BQK (2019)


Deficitin në llogarinë e mallrave<sup>5</sup> arriti vlerën prej 1.4 miliardë euro deri në qershor 2019, që paraqet një rritje vjetore prej 3.9 përqind. Përderisa në vitin 2018 ishte shënuar rënie e eksportit të mallrave dhe përshpejtim i rritjes së importit, në vitin 2019 është duke u shënuar rritje e eksportit të mallrave dhe rritje më e ngadalësuar e importit. Kjo ka ndikuar që shkalla e mbulueshmërisë së importeve me eksporte të ketë një përmirësim të lehtë, nga 10.9 përqind sa ishte në qershor 2018 në 11.1 përqind në qershor 2019.

Eksportit i mallrave deri në qershor 2019 ka shënuar vlerën prej 178.1 milionë euro, që është për 5.5 përqind

<sup>5</sup> Burimi i të dhënave për eksportin dhe importin e mallrave në Kosovë është Agjencia e Statistikave të Kosovës.

më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018 (figura 5).


Figura 5. Eksporti dhe importi i mallrave, në milionë euro



Burimi: ASK (2019)

Rritja e eksportit të mallrave ishte më e theksuar tek metalet bazë, produktet e plastikës dhe gomës si dhe makineritë dhe pajisjet elektrike. Në anën tjetër, rënie shënoj eksporti i produkteve minerale, eksporti i lëkurës dhe artikujve të lëkurës, eksporti i perimeve, etj. (figura 6).

Figura 6. Struktura e eksporteve sipas kategorive, në përqindje




Burimi: ASK (2019)

Vlera e importit të mallrave deri në qershor 2019 ishte 1.6 miliardë euro, që është për 4.0 përqind më e lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018. Rritje më e lartë u shënuar tek importi i produkteve minerale,

ushqimeve, tekstilit dhe artikujve të tekstilit si dhe produktet e plastikës dhe gomës, etj. (figura 7).

Figura 7. Struktura e importeve sipas kategorive, në përqindje




Burimi: ASK (2019)

Bilanci në tregtinë e shërbimeve shënoj vlerën prej 196.2 milionë euro deri në qershor 2019, një rritje prej 17.3 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018. Vlera e gjithsej shërbimeve të eksportuara shënoj rritje vjetore prej 11.3 përqind, duke arritur në 484.6 milionë euro, ndërsa vlera e shërbimeve të importuara shënoj rritje prej 7.6 përqind dhe arriti në 288.4 milionë euro.

Bilanci i llogarisë së të ardhurave parësore, deri në qershor 2019, shënoj vlerën prej 100.5 milionë euro, që paraqet një rritje prej 47.4 përqind. Bilanci i të ardhurave dytësore shënoj rritje për 3.2 përqind, që i atribuohet kryesisht nivelit më të lartë të remitencave. Remitencat e pranuar në Kosovë, që njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore shënuan vlerën prej 405.6 milionë euro deri në qershor 2019, apo 5.5 përqind më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018 (figura 8).

Figura 8. Remitencat, në milionë euro




Burimi: BQK (2019)

Remitencat që pranohen në Kosovë kryesisht vijnë nga Gjermania dhe Zvicra, prej nga dërgohen 41.3 përkatësisht 19.8 përqind e gjithsej remitencave. Një pjesë e konsiderueshme e remitencave është pranuar edhe nga SHBA-të, gjegjësisht 7.1 përqind e gjithsej remitencave të pranuar në Kosovë.

Llogaria financiare deri në qershor 2019 shënoj bilanc prej 160.0 milionë euro (200.1 milionë euro deri në qershor 2018). Në kuadër të llogarisë financiare, hyrjet e IHD-ve në Kosovë arritën vlerën prej 122.5 milionë euro duke shënuar rritje prej 53.2 përqind krahasuar me periudhën e njëjtët të vitit 2018.

Në kuadër të strukturës së IHD-ve, kapitali dhe fondi i investimeve në aksione arriti vlerën prej 84.8 milionë euro dhe shënoj rënie prej 11.6 përqind, ndërsa IHD-të në formë të instrumenteve të borxhit shënuan vlerën prej 37.7 milionë euro (-16.0 milionë euro në periudhën e njëjtët të vitit 2018) (figura 9).

Figura 9. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve, në milionë euro



Burimi: BQK (2019)

Niveli më i lartë i IHD-ve u shënuar në sektorin e patundshmërisë (101.2 milionë euro) dhe krahasuar me periudhën e njëjtët të vitit 2018 kishte rritje për 4.1 përqind. Sektori i dytë për nga rëndësia ishte ai i ndërtimitarisë ku niveli i IHD-ve ishte 14.8 milionë euro (-17.1 milionë euro në periudhën e njëjtët të vitit 2018). Sa i përket origjinës së IHD-ve, Gjermania paraqet vendin prej nga kanë ardhur më së shumti IHD (34.2 milionë euro), pasuar nga Zvicra me 29.1 milionë euro, SHBA-të me 21.5 milionë euro, etj.

**Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:**

BQK (2019): Vlerësimi Tremujor i Zhvillimeve Makroekonomike nr. 27, TM2 2019, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

**Referencat:**

BQK (2019):

- a) Buletini Mujor Statistikor: <http://bqk-kos.org/?id=97>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <https://bqk-kos.org/?id=55>
- c) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandeve për letra me vlerë të qeverisë: <https://bqk-kos.org/?id=107>

ASK (2019):

- a) Indeksi i çmimeve të konsumit: <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/indeksi-i-harmonizuar-i-cmimeve-te-konsumit-ihck-prill-2019>
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-icp-tm4-2018>
- c) Indeksi i çmimeve të importit: <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/indeksi-i-cmimeve-te-importit-icimp-tm4-2018>
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/repertori-statistikor-mbi-ndermarrjet-ekonomike-ne-kosove-tm4-2018>
- e) Statistikat e tregtisë së jashtme: <http://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/statistikat-e-tregtise-se-jashtme-stj-mars-2019>

IMF (2019): World Economic Outlook:

<https://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2019/01/weodata/index.aspx>

## Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	Qershor 2018	Qershor 2019
Sektori real 1/		
Bruto Produkti Vendor (BPV) (në milionë euro)	1,298.8	1,378.7
Çmimet e konsumit (mesatarja vjetore)	0.3%	3.2%
Çmimet e konsumit (fondi i periudhës)	0.8%	2.9%
Sektori fiskal* 2/		
Të hyrat buxhetore (në milionë euro)	792.3	853.5
Shpenzimet buxhetore (në milionë euro)	829.4	853.2
Bilanci primar (në milionë euro)	-37.1	0.3
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	5,995.4	6,666.4
prej të cilave: Bankat	3,891.5	4,303.4
Kredi	2,661.3	2,940.0
Depozita	3,085.9	3,425.3
Norma e interesit në kredi, fondi i periudhës	6.5%	6.3%
Norma e interesit në depozita, fondi i periudhës	1.2%	1.3%
Hendeku i normës së interesit	5.3%	5.1%
Sektori i jashtëm*, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse dhe kapitale	-433.8	-388.4
prej të cilave: remitencat e pranuar	384.5	405.6
Llogaria financiare	-200.1	-160.0
Investimet e huaj direkte në Kosovë	79.9	122.5
Investimet portfolio, net	59.9	-31.7
Investimet tjera, net	-214.5	-265.3
Pozicioni ndërkombëtar i investimeve (PNI), net*	-135.4	-345.6
Asetet	4,776.0	4,884.9
Detyrimet	4,911.4	5,230.6
Borxhi i jashtëm, gjithsej*	2,004.3	2,037.9
Borxhi i jashtëm privat	1,511.6	1,540.7
Borxhi i jashtëm publik	492.7	497.3

Burimi:

1/ ASK (2019), BPV është vetëm për TM1 sepse për TM2 2019 nuk është publikuar ende.

2/ MF (2019).

3/ BQK (2019).

\*Të dhënat për bilancin e pagesave janë deri në qershor 2019 ndërsa për PNI dhe borxh të jashtëm deri në mars 2018.

